



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-035

Prishtinë, më 4 tetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 4 TETOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Enis Kervan dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit,

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu,

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi,

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj, dhe

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 shtator 2011,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 6 tetor 2011,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 shtator 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 shtator 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 6 tetor 2011

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2011, ka caktuar datën e mbajtjes së mbledhjes plenare më 6 tetor 2011, si rendin e ditës. Ndërkohë, në pajtim me përfundimin e Kryesisë, janë propozuar edhe pesë projektligje për shqyrtim të parë dhe një projektligj për shqyrtim të dytë.

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, konfirmoi rendin e ditës për mbledhjen plenare, më 6 tetor 2011, si vijon:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e adresave,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azilin,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për sport,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Policinë,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për nisma legjislative,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësi dhe të procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës,

14. Shqyrtimi i Projekt-Planit hapësinor 2010-2020 -Zona me interes të veçantë ekonomik "Fusha e Mihjes së Re",
15. Shqyrtimi i Propozim-Strategjisë dhe të Planit të veprimit për biodiversitetin 2011-2020,
16. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit, për vitin 2010,
17. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për vitin 2010,
18. Shqyrtimi i Propozimit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e zëvendësve të tij,
19. Njoftimi i deputetëve nga radha e komuniteteve ashkali, egjiptian dhe goran për ndarjen e mandateve për përfaqësimin e tyre në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Njoftimi i Grupit Parlamentar "6+" për ndërrimin e kryetarit të këtij grupi parlamentar me rrotacion

Kryesia u njoftua me propozimin e Grupit Parlamentar "6+" se kryetare e këtij grupi prej 1 tetor 2011, është deputetja Duda Balje, nga radhët e Partisë Boshnjake "VAKAT", në vend të deputetit Rasim Demiri.

3.2 Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës së delegacionit të Asamblesë Nacionale të Kuvajtit, në Kosovë prej datës 8 -10 tetor 2011

Kryesia, lidhur me këtë kërkesë mori këtë:

V E N D I M

Të gjitha shpenzimet e akomodimit, të ushqimit dhe të transporti të brendshëm, si dhe shpenzimet e tjera eventuale, për delegacionin e Asamblesë Nacionale të Kuvajtit, të kryesuar nga Kryetari i saj, z. Jassem Muhammad al Kharafi, që do ta vizitojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës, prej 8-10 tetor 2011, mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

4. Të ndryshme

Kryesia u njoftua se të gjitha materialet për mbledhjen plenare më 6 tetor 2011, u janë shpërndarë deputetëve të Kuvendit edhe në formë elektronike. Një praktikë e tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:30** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.